



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSPEKTORATI I LARTË I  
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT  
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT  
TË INTERESAVE**

Nr.2881 prot.

Tiranë, më 08.10.2020

**PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

Nr.1492 prot.

Tiranë, më 08.10.2020

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NISUR NGA:**

Shqetësimi i opinionit publik shqiptar për nivelin e lartë të korrupsionit, vjedhjeve dhe shpërdorimeve të fondeve publike, priorititet e institucioneve shqiptare dhe kërkesat e vazhdueshme të organizmave të ndryshëm ndërkombëtarë për forcimin e luftës kundër veprave penale të kryera nga zyrtarët e lartë të administratës shtetërore, personat e zgjedhur dhe nëpunësit publikë në Shqipëri;

**ME SYNIM:**

Rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) me Prokurorinë e Përgjithshme, duke respektuar pavarësinë e veprimtarisë së prokurorëve të juridiksonit të përgjithshëm, për forcimin e luftës kundër kriminalitetit të kryer nga zyrtarët e lartë të administratës shtetërore personat e zgjedhur dhe nëpunësit publikë;

**DUKE RIAFIRMUAR:**

Vendosmërinë për respektimin rigoroz të Kushtetutës, Kodit të Procedurave Administrative, Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, gjatë proceseve respektive të punës së të dy institucioneve;

**NË MBËSHTETJE TË:**

Në mbështetje të neneve 15 e 17 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar; nenit 14, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, si dhe nenit 38, pika 2, shkronja “ë” e vijuese të ligjit nr. 97/2016, “Për

organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;

**Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), përfaqësuar nga Inspektori i Përgjithshëm, Z.Shkëlqim Ganaj, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si palë, dhe**

**Prokuroria e Përgjithshme (PP), përfaqësuar nga Prokurori i Përgjithshëm, Z.Olsian Çela, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si palë,**

**bien dakord për marrëveshjen e bashkëpunimit, si më poshtë:**

Neni 1  
**Objekti**

1. Realizimi i bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet palëve, për shkëmbimin e informacioneve për subjektet e deklarimit periodik të interesave private në ILDKPKI, me qëllim evidentimin e saktë të shkeljeve që përbëjnë vepër penale në fushën e deklarimit të pasurisë, konfliktit të interesave dhe veprave penale të tjera që konkurojnë me to ose lidhen me detyrën e subjekteve që kanë detyrim ligjor të bëjnë deklarim periodik.
2. Marja e masave për plotësimin e rregullt të kallëzimeve penale, kryerjen e hetimeve paraprake, ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq në afate sa më të shpejta, në zbatim të ligjit penal dhe procedural penal.
3. Rritja e efikasitetit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional në luftën kundër veprave penale të refuzimit për deklarim, mosdeklarimit, fshehjes ose deklarimit të rremë të pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrim për deklarim, parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal, i veprave penale të tjera që lidhen me to, si: korrupsiuni, vjedhjet e pasurisë, falsifikimet, pastrimi i produkteve të veprave penale dhe veprimtarisë kriminale, etj.
4. Informimi për çështje të tjera me interes të përbashkët të palëve në këtë marrëveshje.
5. Palët do të bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion për realizimin e detyrave respektive, në zbatim të ligjit.

Neni 2  
**Kontributi i ILDKPKI**

1. Në rastet kur ILDKPKI bën kallëzim penal në prokuroritë e juridiksonit të përgjithshëm, materiali, përveç kërkesave të parashikuara në nenin 281 të Kodit të Procedurës Penale, përmban thelbin e veprimeve të kryera dhe rezultatet e arritura gjatë kontrollit, elementët e veprës/veprave penale, shkeljet e akteve ligjore e nënligjore, ekstremitetet dhe përbajtjen e dokumenteve që provojnë mosdeklarimin e saktë, fshehjen ose deklarimin e rremë, dhe shoqërohet me procesverbalet e mbajtur me subjektet e kontrolluara dhe verifikimet e kryera për

sqarimin e pretendimeve të tyre, me dokumentet origjinal<sup>1</sup> që provojnë se subjekti që mbart detyrimin për deklarim nuk ka zbatuar detyrimet ligjore, siç mund të jenë, dokumente bankare, dokumente që vërtetojnë pronësinë mbi pasuri të luajtshme a të paluajtshme, kontrata dhe dokumente notoriale, bilance të aktiviteteve private, licenca, etj, të cilat përbëjnë prova të plota në procesin penal dhe mund t'i nënshtronen ekspertimeve grafike e teknike, etj. Po kështu, kur kallëzimi dërgohet për veprën penale të refuzimit për deklarim ose mosdeklarimit të pasurisë, parashikuar nga neni 257/a/1 të Kodit Penal, i cili kërkon si kusht të domosdoshëm marrjen më parë të masave administrative, kallëzimit i bashkohet akti i masës administrative dhe dokumentet që provojnë se kjo masë i është njoftuar subjektit të kallëzuar.

2. Dokumentet që përbëjnë njoftime anonime, duke mbajtur parasysh parashikimet e nenit 194 të Kodit të Procedurës Penale, ILDKPKI-ja, do t'i përcjellë në organet kompetente që kanë për detyrë zbulimin e veprave penale dhe do të bashkëpunojë me to për dokumentimin e elementeve të veprave penale. Vetëm kur veprat penale të subjekteve që kanë detyrim për deklarim të jenë të dokumentuara ligjërisht, ILDKPKI do të dërgojë kallëzimet në prokurorinë kompetente.
3. ILDKPKI angazhohet të zhvillojë një metodologji lidhur me procedurat e hetimit administrativ dhe të referimit në prokurori të veprave penale.
4. Zhvillimi i metodologjisë dhe zbatimi i saj do të pasohet me trajnime të përbashkëta të inspektorëve ILDKPKI-së dhe prokurorëve të prokurorive të juridikzionit të përgjithshëm, të ngarkuar për ndjekjen e procedimeve penale të regjistrues mbi bazën e kallëzimeve të dërguara nga ILDKPKI.

### Neni 3 **Kontributi i Prokurorisë**

1. Prokurori i Përgjithshëm angazhohet të nxjerrë një udhëzim të përgjithshëm për hetimin e veprave penale të kallëzuara nga ILDKPKI-ja për të normuar marrëdhëniet e prokurorëve të juridikzionit të përgjithshëm dhe oficerëve të policisë gjyqësore që ushtrojnë ndjekjen penale për kallëzimit e bëra nga ILDKPKI-ja, me inspektorët e ILDKPKI-së, pa cënuar pavarësinë e prokurorëve në ushtrimin e ndjekjes penale.
2. Prokuroria e Përgjithshme do të kontribuojë me komente gjatë procesit të hartimit të metodologjisë lidhur me procedurat e hetimit administrativ dhe të referimit në prokurori të veprave penale, të parashikuar në nenin 2, pika 3, të kësaj marrëveshjeje dhe do të garantojë mbështetjen dhe pjesëmarjen për trajnime të përbashkëta me ILDKPKI-në për zbatimin e kësaj metodologjie.
3. Në rastet kur gjatë hetimit të veprave penale të kallëzuara nga ILDKPKI-ja, prokurorët e juridikzionit të përgjithshëm konstatojnë elementet e veprave penale të korruptionit dhe krimtit të organizuar, marrin menjëherë vendim për shpalljen e

---

<sup>1</sup> Ky rregull buron dhe nga neni 191 i Kodit të Procedurës Penale, ku thuhet se vetëm kur origjinali i një dokumenti është prishur, ka humbur ose është zhdukur, mund të merret kopja dhe se dokumentet që përbëjnë prove materiale duhet t'i merren cilitdo personi që i ka krijuar ose i mban.

moskompetencës lëndore dhe kalimin e akteve në Prokurorinë e Posacme, duke njoftuar përmarrjen e këtyre vendimeve ILDKPKI-në.

**Neni 4**  
**Kontributë të përbashkëta**

Palët marrin përsipër që të organizojnë takime të përbashkëta periodike ndërmjet inspektorëve të ILDKPKI, prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të specializuar përmarrjen e veprave penale në fushën e deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave, me qëllim shkëmbimin e opinioneve dhe eksperiencave përmarrjen, interpretimin dhe zbatimin e drejtë të rasteve përmarrjeve cilat bëhet kallëzimi penal, të cilat janë objekt i punës se dy institucioneve.

**Neni 5**  
**Koordinimi ndërmjet Palëve**

1. Palët përmarrjen e zbatimin e kësaj marrëveshje caktojnë nga një person kontakti përmarrjen se cilin institucion.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në vazhdimësi, në varësi të nevojës përmarrjen e shkëmbimit informacioni. Objekti i shkëmbimit të informacionit ndërmjet tyre do të jetë sipas nenit 1 të kësaj marrëveshje.
3. Personat e kontaktit do të informojnë në vazhdimësi drejtuesit e dy institucioneve në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje.

**Neni 6**  
**Administrimi i informacionit**

Informacioni i shkëmbyer mes palëve administrohet sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale; ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Përmarrjen e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar; ligjit nr. 60/2016 “Përmarrjen e sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”; ligjin nr. 119/2014 “Përmarrjen e informimit” dhe ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Përmarrjen e tij të dhënave personale”, i ndryshuar.

**Neni 7**  
**Dispozita të fundit**

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të mbetet në fuqi përmarrjen e këtij nenit.
2. Ndryshime mund të bëhen me marrëveshje nga palët nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.
3. Megjithë sa është parashikuar në pikën 1 të këtij nenit, kjo marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht, me shkrim, palën tjetër.

4. Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje originale, dy prej të cilave depozitohen në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Kontrollit të Interesave dhe dy të tjera në Prokurorinë e Përgjithshme.


Kjo marrëveshje u nënshkrua sot, më datën \_\_\_/\_\_\_/2020.

PËR

**INSPEKTORATIN E LARTË TË  
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT  
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT  
TË INTERESAVE**

**INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**

**SHKËLQIM GANAJ**



PËR

**PROKURORINË E PËRGJITHSHME**

**PROKURORII PËRGJITHSHËM**

**OLSIAN ÇELA**

